



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren, Lirije Maksutaj e me Sekretaren Juridike, Kaltrina Çitaku në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Sh.J, Rr.B, K. nga P, te cilin me aut. e përfaqëson, av.E.R kundër të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Inspektorati i MMPH-së në Prishtinë, për anulim e aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur me dt.07.03.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, Sh.J me të cilën ka kërkuar të anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Inspektorati i MMPH-së në Prishtinë, me Nr.4334, dt.20.11.2013 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i paditësit si në padi por edhe në fjalën e tij përfundimtare të seancës së shqyrtimit kryesore të dorëzuar me shkrim gjykatës mbetet në tërësi si në parashtresën e dorëzuar gjykatës duke kërkuar nga kjo gjykate të anulohet aktvendimi i të paditurës Nr.4347, dt.20.11.2013 me të cilën është urdhëruar rrënimi i objekti paditësit në Prevallë e cila gjendet në parcelën kadastrale... si vendim i kundërligjshëm pasi i njëjti është nxjerr jashtë procedurës me ligj dhe se ankuesi nuk është ftuar nga ministria dhe nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet në një procedurë të rregullt në lidhje me këtë çështje si dhe për faktin se për këtë çështje nuk dhe ndonjë procesverbal të mbajtur. Po ashtu vendimi që urdhërohet rrënimi i objektit nuk ka të bëjë fare me paditësin pasi parcele e paditësit nuk ka qenë e përfshirë në këtë plan urbanistik. Pra vendimi është marr nga një organ jo kompetent dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjeve në fuqi dhe si përfundim rrënimi i objektit është në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat e LPA-së, që i obligon organet administrative ti zbatojnë.

E padituar si në përgjigjen e dhënë me shkrim në padi me dt.18.02.2015, por dhe në parashtresën e dt.17.03.2017 ka kundërshtuar padinë e paditësit si të pabazuar duke i propozuara gjykatës që pas administrimit të provave të refuzoj padinë dhe të mbetet në fuqi akti që kontestohet si në tërësi i bazuar.

Gjykata konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, shqyrtimin kryesor e mbajti në pareni të paditësit të aut. të tij dhe në mungesë të paditurës pasi gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka dëshmi se e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata në seancën e dt.07.03.2017, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt.22.06.2006, vendim i dt.20.11.2013, Nr.prot.4347/13 MMPH, vendim i dt.15.11.13 nr.prot.4271/13, vendim nr. prot.1498/13 dt.03.05.2013, njoftim i dt.22.10.13, flet posedim dt.31.07.2007, kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmerisë, dt.09.02.2006, fatura tatimore në pronë për paditësin, dt.25.11.2013, ankesa e paditësit, përgjigje në padi dt.18.02.2015, përgjigje zyrës së sekretarit të përhershëm dt.29.11.2013.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se, kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar del se, ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton aktvendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë

procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çart dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten për arsye se vetëm dispozitivi me të cilin urdhërohet pronari si në piken I.II.III të tij pa dhënë arsyetim sa i përket pikave të tij nuk plotëson anën formale të një aktit ashtu që të njëjtin e bën të nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e lart cekura të LPA-së. Mos përfshirja e parcelës së paditësit, me nr.136/10 në Zonën Kadastrale Gornja Sellë në planin urbanistik me aktvendimin, e datës 22 Qershor 2006 si dhe vetëm fakti se objekti i ankuesit është pa leje dhe se i njëjtë duhet të rrënohet pa u vlerësuar paraprakisht faktin se në kohën kur është ndërtuar objekti në atë zonë nuk është kërkuar leja e ndërtimit, kjo përben dhe një tjetër shkelje të organit të paditur. Se akti i goditur me padi është i pa çart dhe i papabuar qëndron dhe pretendimi i paditësit se për të njëjtin nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e mirëfillti dhe kjo konstatohet nga shkresat e lëndës nga të cilat shihet se organet administrative nuk kanë zhvilluar procedurën e njoftimit për ankuesin apo hartimin e ndonjë procesverbali mbi rastin e rrënimit të objektit. Po ashtu nga shkresat e lëndës nuk shihet se organet administrative të kenë marrë ndonjë veprim paraprak që të ftojë paditësin që i njëjti të aplikoj për marrjen e lejes pas ndryshimeve që kanë rrjedhë me shpalljen e kësaj pjese Zonë e Mbrojtur dhe turistike nën kushtet që mund të kërkojnë me ligji. Ashtu që ankuesi të mos dëmtohet apo të ketë mundësinë e modaliteve që sa me pak të dëmtohen, pra të mos zbatohet ligji në dem të tij e që në rastin ankuesit shihet që kjo ka ndodhur çoftë me veprime apo mos veprime të ndërmarra nga organet administrative të cilat i kanë në mandatin e tyre e që është dashur ti kenë paryesh paraprakisht para se të vendosin në interesin e përgjithshëm, karshi palëve, mos cenimit të drejtave të garnitura të tyre respektivisht zbatimit të Protokollit nr.1 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në zbatim të nenit 1 të saj.

Në këtë kuptim gjykata vëren se, e paditura ka marrë këtë aktvendim, duke u bazuar në vendimin e ministrit të MMPH-së dt.15.11.2013, i cili vendim është pa arsyetim dhe se, i njëjti vendim nuk i përmban elementet kryesore të aktit administrativ, të përcaktuara me dispozitat ligjore, përkatësisht neneve 84 dhe 85 të Ligjit për Procedurën Administrative. Gjithashtu i njëjti aktvendim vetëm është bazuar në Ligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”, duke mos citur asnjë nen të të njëjtit, i cili do t’i jepte autorizime ministrit të MMPH-së, që të merr vendim, për rrënimin e objekteve pa leje ndërtimore, të ndërtuara para se ky ligj të hynë në fuqi, e të cilat objekte janë, jashtë planit rregullues në parkun nacional në Prevallë, e të cilat gjenden brenda zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se, si është vërtetuar gjendja faktike dhe si është zbatuar ligji procedural e material.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanojë të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1553/2013, dt.07.03.2017

Procesmbajtëse
Kaltrina Çitaku

G j y q t a r e
Lirije Maksutaj

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

